Asamblea e ortakeve te shoqerise "Agrotech 2000", e bledhur sot me date 04.11.2000, ne mbledhjen e saj te jashtezakonshme duke u bazuar ne statutin e saj dhe ne ligjet ne fuqi;

KONSTATON SE:
Ortaku Plamen Dimitriov Hinichovski ne momentin e themelimit te shoqerise "Agrotech 2000" sh.p.k. ka investuar ne kete shoqeri nje shume kapitali ne masen prej 60'000 lek e cila eshte barasvlethshme kjo me 15% te te gjithe kapitalit te shoqerise.
Ortaku Boris Emilov Klein ka investuar ne momentin e thememlimin e shoqerise "Agrotech 2000" nje shume kapitali ne masen prej 200'000 lek e barasvlefshme kjo me 50% te te gjithe kapitalit te shoqerise. Me kontraten noteriale te shitjes se kapitaleve te dates 04.11.2000 te dy ortaket: Plamen Dimitriov Hinichovski dhe Boris Emilov Klein ia shenin pjesen e tyre te kapitalit qe disponojne ne kete shoqeri ortakut te trete te kesaj shoqerie z. Ylli Aliaj.
Ortaku Ylli Aliaj mbetet ortaku dhe pronari i vetem i kapitaleve dhe i pasurive te shoqerise "Agrotek 2000"

VENDOSI:
Te miratoje shitjen e kapitaleve te bere nga ortaket z. Plamen Dimitriov Hinichovski dhe Boris Emilov Klein ne favor te z. Ylli Aliaj kundrejte vleres.
Te miratoje largimin nga shoqeria te ortakeve z. Plamen Dimitriov Hinichovski dhe Boris Emilov Klein.
Ky vendim rregjistrohet ne rregjistrin e shoqerise.

ORTAKET:

Ylli Aliaj | Plamen Dimitriov Hinichovski | Boris Emilov Klein

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER ARBEN NDINO BERAT
Nr. 3213 - 1255

VERTETIM
Sot, diten e shtunë, 04-11-2000, para meje Noterit publik Arben Ndino u paraqiten personalisht ne zyren e Noterise ne Berat ortaket si me siper me identietin e te cileve u njoha ne baze te ligjit, te cilet me vullnetin e tyre te lire nenshkruan kete vendim Asambleje te Ortakeve si me siper ne pranine time. Une Noteri i vertetoje nenshkrimet e tyre ne baze te ligjit.

NOTERI

PULLE TAKSE
50 LEKE
R. SHQIPERISE

<u>KERKESE</u>

<u>KERKUESIT:</u>

Ylli Aliaj i biri i Selfos dtl. 1961, lindur ne qytetin e Beratit dhe banues ne qytetin e Beratit, ne lagjen "Deshmoret e Kombit"

<u>ME OBJEKT:</u>

Depozitimin ne regjistrin tregetar prane Gjykates se rrethit Tirane te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise "BOMIRA" sh.p.k. me nr.02. date 05.11.2000.
Ligja 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare"

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Te nderuar gjyqtare!

Me vendimin nr.21093 date 23.03.1999 te gjykates Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare private "Agrotech 2000".
Me vendim te ortakut te vetem nr.02 date 05.11.2000 eshte bere ndryshimi i emertimit te kesaj shoqerie nga "Agrotech 2000" ne "BOMIRA"
Duke pasur parasysh se ky vendim i ortakut te vetem nuk bie ndesh me ligjen kerkojme nga ana juaj depozitimin ne rregjistrin tregetar te ketij vendimi.

ORTAKU

Ylli Aliaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER ARBEN NDINO BERAT
Nr. 3214 - 1256

<u>VERTETIM</u>

Sot, diten e e diel, 05-11-2000 para meje Noterit publik Arben Ndino u paraqit personalisht ne zyren e Noterise ne Berat ortaku i vetem si me siper me identietin e te cilit u njoha ne baze te ligjit, i cili me vullnetin e tij te lire nenshkruan kete kerkese per depozitimin e vendimit te asamblese, ne pranine time. Une Noteri i vertetoje nenshkrimin e tij ne baze te ligjit.

NOTERI

PULLE TAKSE 50 LEKE R. SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "AGROTECH 2000" SH.P.K.
Nr. 02 vendimi.

## V E N D I M
*Asamblese se Ortakeve*

Asamblea e ortakeve te shoqerise "Agrotech 2000", e bledhur sot me date 05.11.2000, ne mbledhjen e saj te jashtezakonshme me perberje; ortaku i vetem z Ylli Aliaj, duke u bazuar ne statutin e saj dhe ne ligjet ne fuqi;

KONSTATON SE:

Shoqeria "Agrotech 2000" eshte themeluar ne vitin 1999 dhe me vendimin e Gjykates kompetente nr. 21093 23.03.1999 ka fituar zotesi juridike duke u rregjistruar ne rregjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
Duke pare se disa kushte, ide dhe qellime te krijimit te kesaj shoqerise si dhe perberja e saj ka ndryshuar, une ortaku i vetem i shoqerise "Agrotech 2000" sh.p.k.

## V E N D O S A:

Te beje ndryshimin e emertimit te kesaj shoqerie nga "Agrotech 2000" ne "BOMIRA"
Ky vendim rregjistrohet ne rregjistrin e shoqerise.

O R T A K U
Ylli Aliaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER ARBEN NDINO BERAT
Nr. 3214 - 1256

## V E R T E T I M

Sot, diten e diel, 05-11-2000, para meje Noterit publik Arben Ndino u paraqiten personalisht ne zyren e Noterise ne Berat ortaku si me siper me identietin e te cilit u njoha ne baze te ligjit, i cili me vullnetin e tij te lire nenshkruan kete vendim Ortakut te vetem si me siper ne pranine time.
Une Noteri i vertetoje nenshkrimin e tij ne baze te ligjit.

N O T E R I

REPUBLIKA E SHQIPERISE ARBEN P. NDINO

PULLE TAKSE
50 LEKE
R. SHQIPERISE

21093/3

03 06 2005

3 QERSHOR 2005

# KERKESE

**KERKUESI** : z. YLLI ALIAJ, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e administratorit te shoqerise “BOMIRA” sh.p.k

**Objekti** : Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit nr 1, date 01.06.2005 te Ortakut te Vetem shoqerise “BOMIRA” sh.p.k

**GJYKATES SE RRETHIT TIRANE**

Me vendimin nr. 21093, dt. 23.03.1999 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare “BOMIRA” sh.p.k .

Me vendimet nr.21093/1,2, shoqeria “BOMIRA” shpk mbetet ortake dhe administrator te vetem Ylli Aliaj me seli ne Berat, Ura Vajgurore.

Me vendimin e Ortakut te Vetem date 01.06.2005 eshte vendosur :

1. Te caktoje si ekspert kontabel te autorizuar z. Afrim Sula me numer license nr.4 date 11.01.2000 per shtesen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise .
2. Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Ne keto kushte kerkoj depozitimin e ketyre ndryshimeve prane regjistrit tregtar.

KERKUESI
YLLI ALIAJ

**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NR.** 3680 **REP.**

## VERTETIM

Sot me date 02.06.2005, para meje noterit publik, me seli ne Tirane, u paraqit personalisht z.YLLI ALIAJ, shtetas shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet ; madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise “BOMIRA” sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

Noteri

PULLE TAKSE
100 LEKE
RISHQIPERISE
NOTER TIRANE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA TREGETARE** "BOMIRA"sh.p.k.

# V E N D I M
I MBLEDHJES SE JASHTEZAKONSHME TE ORTAKUT TE VETEM

**DATE 01.06.2005**

Sot ne mbledhjen e dates 01.06.**2005**, une ortaku i shoqerise "BOMIRA" sh.p.k. mora ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise dhe ecurine e saj ne te ardhmen dhe ne perputhje me statutin dhe ligjin

## V E N D O S A :

1. Te caktoje si ekspert kontabel te autorizuar z. Afrim Sula per shtesen e kapitalit te nenshkruar te shoqerise .
2. Depozitimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

O R T A K U
YLLI ALIAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 3680

V E R T E T I M

Sot me date 02.06.2005, para meje noterit publik me seli ne Tirane, u paraqit personalisht z.YLLI ALIAJ shtetas shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet ; madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "BOMIRA" sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

Notere

PULLE TAKSE
U LIKUIDUA

NOTERE LIRI GJOLIKU TIRANE REPUBLIKA E SHQIPERISE

Z1093

# KERKESE

**KERKUESIT:**

1. **Ylli Aliaj**, i biri i Selfo, datlindja 1961, lindur e banues ne Berat.
2. **Plamen Dimitrov Hinichovski**, i datlindjes 1967, lindur ne Vartza e banues ne Sofje, Bullgari.
3. **Boris Emilov Klein**, i datlindjes 1958, lindur e banues ne Sofje, Bullgari.

**OBJEKTI:** Rregjistrimin e personit juridik ne baze te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 dhe te ligjit Nr.7512 date 10.08.1991.

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Ne kerkuesit:

1. **Ylli Aliaj**, i biri i Selfo, datlindja 1961, lindur e banues ne Berat.
2. **Plamen Dimitrov Hinichovski**, i datlindjes 1967, lindur ne Vartza e banues ne Sofje, Bullgari.
3. **Boris Emilov Klein**, i datlindjes 1958, lindur e banues ne Sofje, Bullgari.

Kerkojme te rregjistrohemi si person juridik te shoqerise tregetare private "**AGROTECH 2000**" sh.p.k, per te ushtruar aktivitet privat ne fushen e:

1- Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te:
- Mallra te ndryshme industriale, ushqimore, pije, konfeksione, metrazhe, hidro-sanitare, hidraulike, etj.
- Mobilje orendi shtepiake, elektro-shtepiake, kinkaleri-kanceleri zyre e shkollore, etj.
- Paisje elektrike dhe elektronike, makineri-paisje, pjese kembimi te ndryshme etj.
- Produkte bujqesore e blegtorale, fruta-perime, bime medicinale e mjeksore.

2- Rafinim vajra ushqimore, perpunimin, tregtimin dhe trasnsportin e tij.

3- Veprimtari ne fushen e turizmit.

4- Trasport mallra brenda e jashte vendit.

Administrator i shoqerise do te jete z. **Ylli Aliaj** dhe **Boris Emilov Klein.**

Kapitali fillestar eshte 400.000 leke.

Kohezgjatja mbi 10 vjet.

Selia e shoqerise do te jete ne Ura Vajgurore Berat.

Mbetemi me shprese se kerkesa jone do te merret parasysh.

Te regjistrohet. 23.03.99

KERKUESIT

**Ylli Aliaj** **Plamen Dimitrov Hinichovski** **Boris Emilov Klein**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr.....Rep 1504
Nr.....Kol

Tirane me 23.03.1999

VERTETIM

Sot me dt. 23.03.1999 u paraqit para meje zoti(zoterinjte) e sipershenuar, madhore, te njohur personalisht prej meje, per identitetin e te cileve u njoha nga leternjoftimet perkatese, te cilet deklaruan se sa me siper eshte hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe nenshkruhet pa verejtje ne pranine time dhe une e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

NOTERE LIRI GJOLIKU TIRANE

SHOQERIA TREGETARE "BOMIRA" SH.P.K

3 B Procés
30 06 2005

21093/4

Tirane , me 10.06.2005

**KERKESE**

**Kerkuesi:** Shoqeria tregetare "Bomira" sh.p.k, perfaqesuar nga administratori i saj z.Ylli Aliaj.

**Objekti:** Depozitimi ne regjistrin tregetar te vendimit nr.2, date 10.06.2005, te Ortakut te vetem te shoqerise "Bomira" sh.p.k.

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Z. Kryetar!
Shoqeria "Bomira" sh.p.k, eshte rregjistruar si person juridik ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane me vendim nr.21093, date 23.03.1999.
Ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise, me vendimin nr.1 date 01.06.2005 vendosi per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise dhe i kerkoj gjykates caktimin e nje eksperti kontributesh.
Ne baze te kerkeses se mesiperme , Gjykata e Shkalles se Pare Tirane, me vendim nr.21093/3, date 06.06.2005, pranoi kerkesen dhe caktoi si ekspert kontributesh z. Afrim Sula i cili paraqiti prane shoqerise raportin per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
Me vendimin nr.2 date 10.06.2005, Otaku i vetem aprovon raportin e ekspertit dhe vendose per zmadhimin e kapitalit themeltar dhe depozitimin e vendimit te tij ne gjykaten e rregjistrit.
Bashkengjitur kesaj kerkese po ju paraqesim:

- Vendimin nr.2 date 10.06.2005 te Ortakut te vetem te shoqerise "Bomira" sh.p.k
- Raportin e Ekspertit te Kontributeve dhe bilancin e riformuar.

(Te depozitohet kerkesa dt 30.6.05 vendim nr 2 dt 10.6.05 Ortakut Vetem Raport Eks. + Bilanci i Reformuar)

ADMINISTRATORI i SHOQERIS TREGETARE "BOMIRA" SH.P.K

**Ylli ALIAJ**

SHOQERIA TREGETARE "BOMIRA" SH.P.K
ASAMBLEJA E ORTAKEVE(Ortaku i vetem)

VENDIM

Nr. 2 date 10.06.2005

Sot, me date 10.06.2005, Ortaku i vetem e shoqerise tregetare "Bomira" sh.p.k, qe eshte e rregjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, nr. 21093, date 23.03.1999, e bazuar ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe ne statutin e shoqerise, pasi u njoh me raportin e ekspertit te kontributeve, i kerkuar prej tij dhe i caktuar nga gjykata me vendimin nr. 21093/3 date 06.06..2005,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e raportit te ekspertit te kontributeve z Afrim Sula, per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 16.523.000 leke, nepermjet perfshirjes se fitimeve te pashperndara, te mbartura dhe te ushtrimit, te pasqyruara ne llogarite vjetore te ushtrimit 2004.
3. Shtimin e rezerves ligjore me 5% te fitimeve te pashperndara ose 869.551 leke.
4. Ndryshimin e statutit per kapitalin themeltar qe tani lexohet si me poshte: "Kapitali themeltar i shoqerise eshte 16.923.000 leke, ndahet ne 16.923 pjese me vlere nominale 1.000 leke secila dhe zoterohet plotesisht nga z.Ylli Aliaj.
5. Depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregetar .

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGETARE "BOMIRA" SH.P.K**

**Ylli ALIAJ**

# Raport i Ekspertit të Kontributeve

Une Afrim Sula, Ekspert Kontabel i Autorizuar, banues ne Tirane, i rregjistruar ne listen e eksperteve kontabel te hartuar per vitin 2005 nga Instituti Eksperteve Kontabel te Autorizuar (IEKA), jam caktuar me cilesine e ekspertit te kontributeve, ne zbatim te neneve 62 dhe 63 te ligjit Nr.7832 date 19.11.1993 "Per shoqerite tregetare", me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr.21093/3 date 06.06.2005, mbeshtetur ne kerkesen e Ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise "Bomira" sh.p.k z. Ylli Aliaj.

Shoqeria tregetare "Bomira" sh.p.k, eshte krijuar me vendimin vendimin e gjykates tregetare nr. 21093 date 23.03.1999. Kapitali themeltar i saj aktualisht 400.000 leke dhe zoterohet nga ortaku i vetem z.Ylli Aliaj. Fitimet e realizuara nga shoqeria per disa vite nuk jane shperndare por jane mbartur.

Ne miratimin e llogarive vjetore te ushtrimit financiar 2004, Ortaku i Vetem i shoqerise, ka vendosur per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet perfshirjes se fitimeve te mbartura dhe fitimit te ushtrimit, te deklaruara ne pasqyrat financiare te ushtrimit 2004. Ne bilancin vjetor 2004, fitimet e mbartura jane 11.723.343 leke, fitimi i ushtrimit 5.669.208 leke dhe fitime per t'u shperndare gjithsej 17.392.551 leke.

Sipas projek-vendimit te ortakut te vetem, kapitali themeltar i shoqerise do te zmadhohet ne vleren 16.523.000 leke, i ndare ne 16.523 pjese te reja, me vlere nominale 1.000 leke secila, aq sa kane qene vlera nominale e pjeseve ekzistuese.Zmadhimi i kapitalit do te perfitohet nga ortaku i vetem.Pjesa tjeter e fitimeve te pashperndara, ne masen 5% ose 869.551 leke do te kaloje per rritjen e reserves ligjore.

Qellimi i misionit eshte te vleresojme qe, fitimet e mbartura, fitimet e ushtrimit dhe rezervat e shoqerise, qe ortaku i vetem ka vendosur te perfshije ne kapitalin themeltar perfaqesojne realisht aktive ne natyre dhe ne vlere, pra ai konsiston ne vleresimin e ekzistences dhe vleres reale te pasurise qe perbejne aktivin e shoqerise, vleresimin real te detyrimeve dhe verifikimin qe shuma e kapitaleve te veta eshte te pakten e barabarte me aktivin neto te pasqyruar me 31.12.2004. Vleresimi mbeshtetet mbi parimin e vijimesise se aktivitetit te shoqerise.

Per kryerjen e ketij misioni une jam mbeshtetur ne bilancin kontabel te shoqerise te mbyllur me 31.12.2004, inventarin fizik te aktiveve te qendrueshme, te gjendjeve te inventarit, likujditeteve dhe te inventarit kontabel te kerkesave per t'u arketuar dhe detyrimeve, si dhe dokumente te tjera qe u çmuan te nevojshme per misionin.

Ne baze te hapave te ndermara e te punes se kryer , ne jemi ne gjendje tu bejme te njohur perfundimet qe vijojne:

# I. Vleresimi i elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise

## a)Vleresimi i aktiveve te qendrueshme te trupezuara

Inventari fizik i aktiveve te qendryeshme qe zoteron shoqeria me 31.12.2004 eshte pasqyruar ne bilancin bashkangjitur raportit me vleren fillestare (koston historike) prej 9.338.795 leke. Vlera historike e tyre eshte korigjuar me amortizimin e akumuluar 2.715.991 leke, i cili eshte llogaritur ne pershtatje me kohen e perdorimit te cdo elementi inventarial.
Vlera neto kontabel te aktiveve te qendrueshme, si pjese e aktivit gjithsej te shoqerise eshte 6.622.804 leke. Sipas grupeve ato klasifikohen si me poshte:

| Nr | Emertimi | Vlera fillestare | Amortizimi akumuluar | Vlera neto kontabel |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Toka,troje,ndertesa | 3,000,000 | 450,000 | 2,550,000 |
| 2 | Makineri paisje | - | - | - |
| 3 | Mjete trasportie, paisje | 6,338,795 | 2,265,991 | 4,072,804 |
| | Shuma | 9,338,795 | 2,715,991 | 6,622,804 |

Nga verifikimet dhe shqyrtimet tona ne vertetojme se:

- Aktivet e qendrueshme te trupezuara te pasqyruara ne bilancin kontabel te dates 31.12.2004 dhe ne inventarin fizik te tyre, ekzistojne fizikisht dhe shoqeria eshte pronare e tyre.
- Vlera fillestare e tyre vertetohet nga dokumentat e blerjeve dhe amortizimi i llogaritur gjate perdorimit te tyre mbeshtetet ne metoda dhe norma qe japin nje zhvleresim real te tyre.
- Vlera neto kontabel e prej 6.622.804 leke nuk eshte e mbivleresuar, por pasqyrohet me nje vleresim normal dhe te arsyeshem.Vlera aktuale e tregut qe ato mbartin nuk mund te jete me e vogel se ajo qe paraqitet aktivin e bilancit kontabel.

## b)Vleresimi i aktiveve qarkulluese

Aktivet qarkulluese te shoqerise me 31.12.2004 perbehen :

| | |
|---|---|
| • Gjendje te inventarit dhe ne proces | 15.689.880 leke |
| • Kerkesa per arketim mbi debitoret | 10.163.287 leke |
| • Likuiditete dhe vlera arke | 1.188.279 leke |
| Shuma: | 27.041.446 leke |

Gjendjet e inventarit perfaqesohen nga mallrat e gatshme per shitje, te cilat jane inventarizuar fizikisht ne fund te ushtrimit. Vleresimi i tyre eshte bere me cmimet e e blerjes te muajit dhjetor 2004.Per rrjedhim vlera e paraqitur perfaqeson nje aktiv qe ekziston si prone e shoqerise dhe eshte e vleresuar ne menyre te drejte.
Kerkesa per arketim mbi debitoret ne postin "Kliente per shitje e sherbime" me vlere 10.163.287 leke, perfaqesohet nga vlera e mallrave te faturuara nga shoqeria e te pranuara nga klientet, por qe ende nuk jane arketuar me 31.12.2004.Kerkesat ndaj klienteve jane emerore dhe konfirmohen per tepricen nga rakordimi dokumentar i marredhenieve.Te gjithe klientet vleresohen te

arketueshem.Nga vleresimet tona rezulton se te drejtat financiare te paraqitura, ekzistojne dhe jane te arketuesheme,pra jane vlera reale pasurore te shoqerise.
Likujditetet perbehen nga gjendjet e parave ne arke me vlere 93.415 leke te cilat vertetohen me inventarit fizik te dates 31.12.2004 dhe nga likujditetet ne llogarine bankare per 1.094.864 leke te cilat gjithashtu jane te konfirmuara me nxjerrjet bankare.
Si perfundim, aktivet qerkulluese te paraqitura ekzistojne, i perkasin shoqerise dhe jane me vleresimin normal dhe te arsyeshem.

## II.Vleresimi i detyrimeve te shoqerise

Detyrimet e shoqerise ne fund te ushtrimit 2004 paraqiten si me poshte:

- Provizione per rreziqe(lehtesia tatimore e pa skaduar) 0 leke
- Detyrime te kerkueshme pas me shume se nje viti 5.000.00 0 leke
- Detyrime te kerkueshme deri ne nje vite 10.831.699 leke

Shuma: 15.831.699 leke

Detyrime te kerkueshme,me afat shlyerje me shume se nje vite, jane detyrime qe shoqeria ka ndaj ortakut te vetem te saj.Detyrime te kerkueshme deri ne nje vite, jane detyrime ndaj personelit, sigurimeve shoqerore dhe D.T.Taksave, te cilat ekzistojne me vleren e tyre te paraqitur ne bilanc.Detyrimet ndaj furnitoreve prej 6.528.844 leke jane te analizuara dhe tepricat e tyre jane rrjedhim i marredhenieve qe jane realizuar me secilin prej tyre.Shuma e paraqitur perfaqesor nje detyrim real per shoqerine.
Per te gjitha detyrimet, deri ne diten e hartimit te ketij raporti,ne nuk morem dijeni per ndonje konflikt ose rrezik te mundshem qe mund te ndryshoje ato.
Si perfundim, detyrimet e shoqerise ekzistojne, i perkasin shoqerise dhe perfaqesojne detyrime reale te shoqerise ndaj te treteve.

## III. Vlera e pasurise neto te shoqerise(Aktivi neto)

Vlera neto e pasurise se shoqerise(aktivi neto) eshte product i differences se aktiveve gjithsej me detyrimet e shoqerise ne momentin e dhene.Sipas vleresimeve te mesiperme vlera neto e pasurise me 31.12.2004 rezulton:

| Nr | Emertimi | Sipas bilan.kontabel 31.12.2004 | Sipas vleresimit eksp. 31.12.2004 |
|---|---|---|---|
| a | Aktivet e shoqerise | 33.664.250 | 33.664.250 |
| b | Detyrimet gjithsej | 15.831.699 | 15.831.699 |
| | Detyrime ndaj te treteve | 15.831.699 | 15.831.699 |
| | Lehtesia tatimore | 0 | 0 |
| c | Aktivi neto(pasuria neto) | 17.832.551 | 17.832.551 |

Pas vleresimit tone, rezulton se kapitalet e veta te shoqerise, si ekujialente te aktivit neto, nuk ndryshojne nga ato te paraqitura ne bilancimn kontabel te 31.12.2004. Nga krahasimi i aktivit neto sipas vleresimit tone, me kapitalet e veta te paraqitura ne bilancin e dates 31.12.2004, del perfundimi se elementet e kapitaleve te veta, si kapitali themeltar, rezervat e fitimet e pashperndara kane ekuivalencen e tyre te plote ne pasurine neto te shoqerise.

Ne menyre te permbledhur pamja e bilancit kontabel pas zmadhimit do te paraqitej:

| Nr | Emertimi | Sipas bilan.kontabel 31.12.2004 | Pas zmadhimit te kap. themeltar |
|---|---|---|---|
| a | Aktivet e shoqerise | 33.664.250 | 33.664.250 |
| b | Detyrimet gjithsej | 15.831.699 | 15.831.699 |
| | Detyrime ndaj te treteve | 10.831.699 | 10.831.699 |
| | Detyrime ndaj ortakut | 5.000.000 | 5.000.000 |
| | Provizione per lehtesine tatimore | 0 | 0 |
| | Kapitalet e veta | 17.832.551 | 17.832.551 |
| | Kapitali themeltar | 400.000 | 16.923.000 |
| | Rezerva liggore | 40.000 | 909.551 |
| | Rezerva te tjera | 0 | 0 |
| | Fitime e humbje te mbartura | 11.723.343 | 0 |
| | Fitime e humbje te ushtrimit | 5.669.208 | 0 |
| | | | |
| | | | |

**Perfundimi:**

- Te bazuar ne verifikimet qe ne kemi kryer, vertetojme se, rritja e kapitalit themeltar te shoqerise "Bomira" sh.p.k, Berat, ne **vleren 16.523.000 leke** nepermjet perfshirjes se fitimeve te mbartura dhe fitimit te ushtrimit 2004, ka ekuvalentin e saj ne pasurine neto te shoqerise. Vlera neto e pasurise se vleresuar (aktivi neto) nuk eshte me e vogel se kapitalet e veta te shoqerise te treguara ne bilancin kontabel te mbyllur me 31.12.2004. Projekt-vendimi i Ortakut te Vetem per zmadhimin e kapitalit themeltar me ane te perfshirjes se fitimeve te pashperndara, eshte i drejte.

**EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR**

**Afrim SULA**

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR AFRIM SULA

Tirane , me 09.06.2005

# BILANCI KONTABEL TE SHOQERISE "BOMIRA" SH.P.K PARA DHE PAS SHTESES SE KAPITALIT THEMELTAR
## (Bilanci i riformuar)

| | AKTIVI | Nr | Fakti 2004 | I riformuar 2004 |
|---|---|---|---|---|
| A | KAPITALI NENSHKRUAR I PAKERKUAR | 1 | 0 | 0 |
| B | AKTIVE TE QENDRUESHME | 2 | 6,622,804 | 6,622,804 |
| | I.TE PATRUPEZUARA | 3 | 0 | 0 |
| | a)Shpenzime te nisjes e te zgjerimit | 4 | | 0 |
| | b)Shpenzime te kerkimeve te aolik. | 5 | 0 | 0 |
| | c)Te tjera ne zhvillim | 6 | 0 | 0 |
| | d)Pagesa pjesore te derdhura | 7 | 0 | 0 |
| | e)Amortizime | 8 | 0 | 0 |
| | h)Provizione per zhvleresim | 9 | 0 | 0 |
| | II.TE TRUPEZUARA | 10 | 6,622,804 | 6,622,804 |
| | a)Toka,troje ,terrene,nder.e insta.pergj. | 11 | 3,000,000 | 3,000,000 |
| | b)Instalime teknike,makineri,paisje,veg. | 12 | 0 | 0 |
| | c)Te tjera ne sfrytezim | 13 | 6,338,795 | 6,338,795 |
| | d)Ne proces dhe pagesa pjesore | 14 | 0 | 0 |
| | e)Amortizime | 15 | -2,715,991 | -2,715,991 |
| | h)Provizione per zhvleresim | 16 | 0 | 0 |
| | III.FINANCIARE | 17 | 0 | 0 |
| | a)Pjesmarrje dhe tituj funanciare te tjer. | 18 | 0 | 0 |
| | b)Kerkesa debitore te lidhura me pjes. | 19 | 0 | 0 |
| | c)Kredi te dhena | 20 | 0 | 0 |
| | d)Provizione per zhvleresime | 21 | 0 | 0 |
| C | AKTIVE QARKULLUESE | 22 | 27,041,446 | 27,041,446 |
| | I.GJENDJE TE INVENTARIT DHE NE PROCES | 23 | 15,689,880 | 15,689,880 |
| | a)Mareriale te para dhe materiale te tjera | 24 | 0 | 0 |
| | b)Prodhime,punime,sherbime ne proces | 25 | 0 | 0 |
| | c)Produkte dhe mallra | 26 | 15,689,880 | 15,689,880 |
| | d)Te tjera gjendje inventari | 27 | 0 | 0 |
| | e)Provizione per zhvleresime | 28 | 0 | 0 |
| | II.KERKESA PER ARKETIMIN MBI DEBITORET | 29 | 10,163,287 | 10,163,287 |
| | Nga keto me afat pas me shume se nje vit | 30 | | 0 |
| | a)Kliente per shitje e sherbime | 31 | 10,163,287 | 10,163,287 |
| | b)Ortake kapital i pa derdhur | 32 | 0 | 0 |
| | c)Personeli dhe persona | 33 | 0 | 0 |
| | d)Te tjera kerkesa | 34 | 0 | 0 |
| | e)Provizione per zhvleresime | 35 | 0 | 0 |
| | III.LETRA ME VLERE TE VENDOSJES SE PERKOS | 36 | 0 | 0 |
| | a)Aksione,obligacione ,bono thesari,te ngja. | 37 | 0 | 0 |
| | b)Provizione per zhvleresim | 38 | 0 | 0 |
| | IV.LIKUJDITETE DHE VLERA ARKE TE TJERA | 39 | 1,188,279 | 1,188,279 |
| | a)Depozita ne banke dhe llogari te tjera | 40 | 1,094,864 | 1,094,864 |
| | b)Para ne dore (arke) | 41 | 93,415 | 93,415 |
| | c)Vlera arke te tjera | 42 | 0 | 0 |
| | V.SHPENZIME TE PAGUARA OSE TE RREGJIS.VA | 43 | 0 | 0 |
| | Nga keto:mbi nje vit | 44 | | 0 |
| D | LLOGARI TE TJERA | 45 | 0 | 0 |
| | a)Shpenzime kosto per tu shperndare | 46 | 0 | 0 |
| | b)Digerenca konvertimi AKTIVE | 47 | 0 | 0 |
| | TOTALI I AKTIVIT | 48 | 33,664,250 | 33,664,250 |
| | LLOGARI JASHTE BILANCIT | 49 | 0 | |
| | AKTIVE TE QENDRUESHME TE MARRA ME QIRA | 50 | 0 | |
| | PASURI TE TJERA TE TE TRETEVE | 51 | 0 | |
| | TE TJERA LLOGARI JASHT BILANCIT | 52 | 0 | |

| | PASIVI | Nr. | Fakti 2004 | I riformuar 2004 |
|---|---|---|---|---|
| A | KAPITALET E VETA | 1 | 17,832,551 | 17,832,551 |
| | I.KAPITALI THEMELTAR REZERVAT FITIME HUMBJE | 2 | 17,832,551 | 17,832,551 |
| | Nga ky i derdhur | 3 | | 0 |
| | a)Kapitali nenshkruar | 4 | 400,000 | 16,923,000 |
| | b)Prime te lidhura me kapitalin | 5 | 0 | 0 |
| | c)Diference nga rivleresimi | 6 | 0 | 0 |
| | d)Rezervat | 7 | 40,000 | 909,551 |
| | -Rezervat ligjore | 8 | 40,000 | 909,551 |
| | -Rezervat statuore | 9 | 0 | 0 |
| | -Rezervat e tjera | 10 | 0 | 0 |
| | e)Fitime ose humbje te mbartura | 11 | 11,723,343 | 0 |
| | h)Fitime ose humbje te ushtrimit | 12 | 5,669,208 | 0 |
| | II.FONDE TE TJERA TE VETAT | 13 | 0 | 0 |
| | a)Fondi i zhvillimit | 14 | 0 | 0 |
| | b)Fondi shperblimit suplementar | 15 | 0 | 0 |
| | c)Fondi i ndihmave te menjehereshme | 16 | 0 | 0 |
| | d)Fonde te tjera | 17 | 0 | 0 |
| | III.SUBVECIONE PER INVESTIME | 18 | 0 | 0 |
| | IV.PROVIZIOBE OER RREZIQE E SHPENZIME | 19 | 0 | 0 |
| | a)Provizione per rreziqe | 20 | 0 | 0 |
| | b)provizione oer shpenzime | 21 | 0 | 0 |
| B | DETYRIME | 22 | 15,831,699 | 15,831,699 |
| | I.DETYRIME TE KERK. PAS ME SHUME SE NJE VIT | 23 | 5,000,000 | 5,000,000 |
| | a)Huara nga bankat dhe institutet e kred. | 24 | 0 | 0 |
| | b)Huara te tjera | 25 | 0 | 0 |
| | c)Shuma te arketuara me porosi | 26 | 0 | 0 |
| | d)Furnitore per blerje e sherbime | 27 | 0 | 0 |
| | e)Shteti | 28 | 0 | 0 |
| | h)Ortake | 29 | 5,000,000 | 5,000,000 |
| | f)Detyrime te tjera | 30 | 0 | 0 |
| | II.DETYRIME TE KERKUESHME DERI NE NJE VIT | 31 | 10,831,699 | 10,831,699 |
| | a)Huara nga bankat dhe institutet e kred. | 32 | 0 | 0 |
| | b)Huara te tjera | 33 | 0 | 0 |
| | c)Shuma te arketuara me porosi | 34 | 0 | 0 |
| | d)Furnitore per blerje e sherbime | 35 | 6,528,844 | 6,528,844 |
| | e)Personeli | 36 | 0 | 0 |
| | h)Sigurime shoqerore | 37 | 40,767 | 40,767 |
| | f)Shteti tatim taksa | 38 | 116,778 | 116,778 |
| | g)Ortake | 39 | 0 | 0 |
| | i)Te tjera detyrime | 40 | 4,145,310 | 4,145,310 |
| | III.TE ARDHURA TE MARRA OSE TE RRE.AVANCE | 41 | 0 | 0 |
| C | LLOGARI TE TJERA | 42 | 0 | 0 |
| | a)Diferenca konvertimi pasive | 43 | 0 | 0 |
| | | 44 | | 0 |
| | TOTALI PASIVIT | 45 | 33,664,250 | 33,664,250 |
| | LLOGARI JASHTE BILANCIT | 46 | 0 | 0 |

| | | |
|---|---|---|
| Kuadrimi aktiv-pasiv | 0 | 0 |
| Kuadrimi fitimit neto (bilanci-pasqyra e fitime-humbje) | 0 | 0 |

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR AFRIM SULA

21093/4

25 NENTOR 2005

**SHOQERIA TREGTARE "BOMIRA" SH.P.K.** Berat, me 25.11.2005

# KERKESE

**KERKUESI:** Shoqeria tregtare "BOMIRA" SH.P.K e perfaqesuar nga Administratori i saj Z. Ylli ALIAJ, i biri i Selfos, lindur me 02.08.1961 ne Kapaj Fier dhe banues ne Uren Vajgurore Berat.

**OBJEKTI:** Depozitimi i vendimit Nr.4 date 25.11.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise tregtare "BOMIRA" sh.p.k .

**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**
***TIRANE***

Z. Kryetar!

Shoqeria tregtare "BOMIRA" shpk eshte krijuar si person juridik me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr.21093 date 23.03.1999. Me vendim te ortakut te vetem Nr.4 date 25.11.2005 eshte vendosur zmadhimi i kapitalit themeltar me kontribut ne para dhe ndryshimi i nenit 5 te statutit te saj.

Ne zbatim te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar", kerkohet depozitimi i vendimit Nr.4 date 25.11.2005 te Ortakut te Vetem te shoqerise tregtare "BOMIRA" sh.p.k.

Bashkangjitur kesaj kerkese po ju paraqesim:

- Vendimin e Ortakut te Vetem Nr. 4 date 25.11.2005.
- Çertifikaten e depozitimit te fondeve ne Raiffeisen Bank Dega Berat

**KERKUESI**
**ADMINISTRATORI DHE ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**
**"BOMIRA"SH.P.K**
**YLLI ALIAJ**

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

**SHOQERIA TREGTARE "BOMIRA" SHPK**

# VENDIM

Nr.4 date 25.11.2005

Sot, me date 25.11.2005, une Ylli ALIAJ Ortaku i Vetem i shoqerise tregtare "BOMIRA" sh.p.k, e rregjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr.21093 date 23.03.1999 bazuar ne ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ne statutin e shoqerise,

**VENDOSA:**

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "BOMIRA" sh.p.k nepermjet nenshkrimit te pjeseve te reja nga ortaku i vetem i saj Z.Ylli Aliaj. Zmadhimi i kapitalit themeltar te behet per shumen 20.000.000 leke. Nenshkrimi dhe shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar eshte e menjehereshme nepermjet depozitimit te 20.000.000 leke me date 25.11.2005 ne Raiffeisen Bank Dega Berat, siç vertetohet nga Certifikata e Depozitimit bashkangjitur ketij vendimi.
2. Ndryshimin e Nenit 5 te Statutit te shoqerise qe tani lexohet si me poshte:
   - Kapitali themeltar i shoqerise eshte 36.923.000 leke i ndare ne 36.923 pjese me vlere nominale 1000 leke secila dhe zoterohet teresisht nga ortaku i vetem Z.Ylli Aliaj.
3. Depozitimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGTARE "BOMIRA"SH.P.K**
**YLLI ALIAJ**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**NOTERE ARBEN NDINO, BERAT**
**Nr** 1703 - 433

**VERTETIM**

Sot, me 25.11.2005, para meje Noterit Arben Ndino ne Berat, u paraqit personalisht Z.Ylli Selfo Aliaj lindur ne Kapaj Fier dhe banues ne Uren Vakjgurore me numer pasaporte 0012658 ne cilesine e Administratorit dhe ortakut te vetem te Shoqerise "BOMIRA" Sh.p.k, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova pasi verifikova dokumenin e tij identifikuese. Ai pasi lexoi vendimin e mesiperm, e nenshkroi lirisht para meje Noterit me vullnetin e tij te lire, dhe une Noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERE**
**ARBEN NDINO**

Raiffeisen BANK

**Raiffeisen Bank**
**Dega Berat**

**Berat,25.11.2005**

# V E R T E T I M

Vertetojme se z.Ylli Selfo Aliaj ka depozituar ne llogarine e tij personale ne leke me nr 0001004895 prane Raiffeisen Bank, Dega Rajonale Berat,shumen 20.000.000 \njezetmilion \ leke, per shtese kapitali themeltar te „BOMIRA „ shpk.

E leshojme kete vertetim me kerkesen e klientit.

**D R E J T O R E**
**Dhurata DUNDO**

Raiffeisen BANK Sh.A Dega Rajonale Berat, Shqipëri